

L I G J

PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PER QEVERINE E REPUBLIKES SE MAQEDONISE

Neni 1

Ne Ligjin per Qeverine e Republikes se Maqedonise ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008, 82/2008, 10/10, 51/11, 15/13 dhe 139/14) pas nenit 42 shtohet titulli i ri XIII si vijon "ZGJEDHJE PER QEVERI PER ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE PER DEPUTETE" dhe neni i ri 43, si vijon:

Neni 43

Njeqind dite para mbajtjes se zgjedhjeve per deputete, e me doreheqje paraprake te Kryetarit te Qeverise se Republikes se Maqedonise, Kuvendi i Republikes se Maqedonise do te zgjedhe Qeveri te re, kalimtare per zbatimin e zgjedhjeve per deputete, te udhehequr nga kryetari i ri i Qeverise te cilin e emerone partia me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise.

Neni 2

Pas nenit 43 shtohen tete nene te reja 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50 dhe 51, si vijojne:

Neni 44

- (1) Per organizimin e zgjedhjeve te parakohshme per deputete ne vitin 2016, Kuvendi i Republikes se Maqedonise me propozim te Kryetarit te Qeverise se Republikes se Maqedonise zgjedh minister te Puneve te Brendshme dhe minister te Punes dhe Politikes Sociale, me propozim te opozites.
- (2) Ministrin e Puneve te Brendshme e propozon partia ne opozite me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise, me konsultim paraprak me dy partite politike me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise.
- (3) Ministrin e Punes dhe Politikes Sociale e Propozon partia ne opozite me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise.
- (4) Ministri i Puneve te Brendshme mund te kryeje shkarkim ose sistematizim ne vend te njejte, me te ulet ose me te larte te bartesit te pozites udheheqese ne ministri ne pajtim me Ligjin.
- (5) Ne ditene emerimit te personit ne pozite udheheqese nga paragrafi (4), ministri eshte i obliguar te emeroje zevendes plotesues me propozim te zevendesministrit plotesues.
- (6) Zevendesministri plotesues nepunesit udheheqes nga paragrafi (5) bashkerisht dhe ne menyre te barabarte merr pjese ne zbatimin e kompetencave te cilat dalin nga ligji dhe aktet nenligjore.

(7) Te gjitha aktet ne kompetence te nepunesit udheheqes duhet te nenshkruhen edhe nga nepunesi udheheqes edhe nga zevendesi plotesues i nepunesit udheheqes. Nese akti eshte i nenshkruar vetem nga njeri person konsiderohet se ai nuk nxjerr veprim juridik.

Neni 45

Per organizimin e zgjedhjeve te parakohshme per deputete ne vitin 2016, Kuvendi i Republikes se Maqedonise me propozim te Kryetarit te Qeverise se Republikes se Maqedonise zgjedh zevendesminister plotesues te ministrit (ne tekstin e metejme: zevendesministri plotesues i ministrit) ne:

- Ministrine e Puneve te Brendshme - i propozuar nga partia politike ne pushtet me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise;
- Ministrine e Punes dhe Politikes Sociale - i propozuar nga partia politike ne qeveri me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise;
- Ministrine e Financave - i propozuar nga partia politike ne opozite me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise;
- Ministrine e Bujqesise Pylltarise dhe Ekonomise se Ujerave -i propozuar nga partia politike ne opozite me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise;
- Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates - i propozuar nga partia politike ne opozite me numer me te madh te deputeteve ne Kuvendin e Republikes se Maqedonise.

Neni 46

(1) Mandati i zevendesministrit plotesues te ministrit zgjat nga dita e zgjedhjes se tij deri ne ditën e zgjedhjes se Qeverise pas perfundimit te zgjedhjeve te parakohshme per deputete qe do te mbahen ne vitin 2016.

(2) Zevendesministri plotesues i ministrit bashkerisht dhe ne menyre te barabarte me ministrin merr pjese ne realizimin e kompetencave te parapara ne Ligjin per organizimin dhe punen e organeve te administrates shteterore.

(3) Zevendesministri plotesues i ministrit, bashkerisht dhe ne menyre te barabarte me ministrin i shqyrton dhe nenshkruan te gjitha aktet dhe dokumentet te cilat i miraton ministri ose personat e autorizuar nga ai, zevendesministri si dhe sekretari shteteror ne ministrine perkatese, ndersa kane te bejne me ceshtje juridike, financiare dhe kadrovike te lidhura me organizimin e zgjedhjeve.

(4) Cdo akt ne kuptimin e ketij ligji dorezohet te ministri dhe zevendesministri plotesues. Ministri dhe zevendesministri plotesues jane te obliguar menjehere, e me se voni ne afat prej nje dite ta miratojne ose refuzojne aktin ne kuptimin e ketij ligji.

Neni 47

Nese akti ose dokumenti nga neni 46 paragrafet (3) dhe (4) te ketij ligji eshte miratuar, gjegjesisht nenshkruar vetem nga njeri person konsiderohet se i njejti nuk nxjerr veprim juridik.

Neni 48

- (1) Ne rast te mospajtimit ndermjet ministrit dhe zevendesministrit plotesues ne Ministrite nga neni 2 i ketij ligji lidhur me ate nese ndonje ceshtje e caktuar juridike, financiare dhe kadrovike ka te beje me organizimin e zgjedhjeve, Komisioni Shteteror Zgjedhor eshte i obliguar, ne afat prej 24 oreve te miratoje vendim dhe te njejtin ta percjelle ne ministrine perkatese.
- (2) Vendimi i Komisionit Shteteror Zgjedhor eshte perfundimtar.
- (3) Ne rast te dyshimit qe del nga veprimi i mundshem joligjor nga ministri dhe/ose zevendesi i tij plotesues, mund te ngrihet padi ne gjykatën kompetente. Ne rast te kontestohen procedurat administrative dhe vendimet, per ato mund te ngrihet padi ne Gjykatën Administrative kompetente.

Neni 49

- (1) Me hyrjen ne fuqi te ketij ligji, zevendesministri plotesues i ministrit ka te drejte ne qasje te pakufizuar te te gjitha aktet, dokumentet dhe informatat te cilat i ka ne disponim ministri.
- (2) Te punesuarit ne ministri me kerkese te zevendesministrit plotesues te ministrit jane te obliguar t'ia dorezojne te gjitha aktet, dokumentet dhe informatat te cilat i ka ne disponim ministri.

Neni 50

Te drejtat e percaktuara ne Ligjin per rroga dhe kompensime tjera per persona te zgjedhur dhe te emeruar ne Republiken e Maqedonise ("Gazeta Zyrtare e RSM-se" numer 36/1990 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 38/1991, 23/1997, 37/2005, 84/2005, 121/2007, 161/2008, 92/2009 , 42/10, 97/10, 162/10, 111/12, 145/12, 170/13 dhe 139/14) i takojne edhe zevendesministrit plotesues te ministrit nga dita e emerimit, deri ne fund te muajit ne te cilin i eshte nderprere funksioni.

Neni 51

- (1) Zevendesministri plotesues i ministrit ka te drejte per keshilltare te vecante dhe nepunes ne kabinet numri i te cileve eshte ekuivalent me numrin e keshilltareve te vecante dhe nepunesit e kabinetit ne kabinetin e ministrit, sipas Ligjit per nepunes administrative.
- (2) Vendet e vecanta te punes nga paragrafi (1) i ketij neni mund te plotesohen me nepunes administrative (mobilitet) ose ne procedure pa shpalljen e konkursit publik.
- (3) Punesimi ne vendet e vecanta te punes nga paragrafi (2) i ketij neni zgjat deri ne skadimin e mandatit te zevendesministrit plotesues.
- (4) Punesimi ne vendet e vecanta te punes nga paragrafi (2) i ketij neni mund te nderpritet edhe para skadimit te mandatit me kerkese te zevendesministrit plotesues ose me kerkese te te punesuarit.
- (5) Gjate kryerjes se detyrave te punes ne kabinetin e zevendesministrit plotesues te punesuarit nga paragrafi (2) i ketij neni i pushojne te drejtat e marredhenies se punes nga vendi paraprak i punes.

(6) I punesuari nga paragrafi (2) i ketij neni ka te drejte te kthehet te punedhenesi paraprak ne vendin e njejte ose te ngjashem te punes qe pershtatet me pergatitjen e tij profesionale me se shumti ne afat prej pese diteve nga dita e nderprerjes se shkakut te pushimit te te drejtave nga marredhenia paraprake e punes.

(7) Rroga dhe kompensimet tjera te te punesuarve nga paragrafi (1) i ketij neni eshte perkatese me rrogen e keshilltareve te vecante dhe nepunesve te kabinetit ne kabinetin e ministrit.

Neni 3

Ky ligj hyn ne fuqi ne ditën e botimit ne "Gazeten Zyrtare te Republikes se Maqedonise", ndersa do te zbatohet deri ne zgjedhjen e Qeverise pas perfundimit te zgjedhjeve te parakohshme parlamentare ne vitin 2016, pervec nenit 43.